

**TREGUESIT E REALIZIMIT TË
BUXHETIT TË
BASHKISË TIRANË
8 MUJORI 2023**



PËRMBAJTJA E RAPORTIMIT

1. Hyrje

2. Kuadri Ligjor

3. Përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit

4. Tabelat e raportimit të monitorimit

4.1 Realizimi i të ardhurave për periudhën janar - gusht 2023

4.2 Tabela e raportit të shpenzimeve sipas programeve

4.3 Tabela e raportit të shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik

4.4 Tabela e raportit sipas burimeve të financimit

4.5 Tabela e raportit të donacioneve

4.6 Tabela e raportit të fondeve të kushtëzuara

4.7 Tabela e raportit të investimeve me financim të brendshëm

4.8 Përdorimi i fondit rezervë dhe fondit të kontigjencës

5. Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

6. Raportimi i detyrimeve të prapambetura

7. Ecuria e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitet 2020-2023

RAPORT MONITORIMI I BASHKISË TIRANË PËR 8-MUJORIN 2023

1. Hyrje

Raporti i monitorimit paraqet monitorimin e zbatimit të buxhetit, performancën financiare të njësisë dhe krahasimin e treguesve faktikë të performacës me ato të planifikuar. Nëpërmjet procesit të monitorimit evidentohet nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, ndjekja e qëllimit dhe objektivave të vendosura, si dhe sigurimi i informacionit do të shërbejë për përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të zbatimit të buxhetit.

Për vitin 2023 Bashkia Tiranë ka si qëllime:

- **Infrastrukturën urbane të qëndrueshme** duke maksimizuar sigurimin e infrastrukturës zhvillimore, kritike dhe sociale që të jetë në propocion të drejtë me shkallën e zhvillimit dhe të zgjerimit të popullsisë në qytet.
- **Arsimi për të gjithë:** Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës arsimore si dhe krijimi i infrastrukturave të reja do të vazhdojë të jetë një objektiv strategjik edhe për vitin 2023. Gjithashtu Bashkia e Tiranës i ka dhënë prioritet më shumë se kurrë rritjes së aksesueshmërisë arsimore për grupet e pa favorizuara si; fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në zona të thella rurale dhe ata me ndihmë ekonomike duke iu përmbajtur vizionit të saj dhe atij kombëtar. Rezidencat universitare do të vazhdojnë të jenë në fokus të punës së BT edhe për këtë vit duke qenë se Tirana akomodon numrin më të lartë të studentëve në të gjithë Shqipërinë, kjo jo vetëm për faktin se në kryeqytete janë përqëndruar numri më i madh i institucioneve të arsimit të lartë por sepse metropoli ofron më shumë mundësi për punësim.
- **Zhvillimi i Ekonomisë së qëndrueshme në qytet:** Duke qenë se zhvillimi i ekonomisë është një proces transformimi në të cilin shfrytëzimi i burimeve natyrore, përzgjedhja e investimeve, orientimi i ndryshimeve teknologjike dhe institucionale realizohen duke garantuar qëndrueshmëri në të ardhmen, janë parashikuar programe e projekte që synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset, mbështetje financiare dhe incentiva fiskale, rritja e konkurrencës dhe thithja e investimeve të huaja.
- **Tirana qytet i rimëkëmbur nga tërmeti dhe pandemia dhe më i jetueshëm:** Nëpërmjet këtij objektivi, synohet përmirësimi i një sërë elementesh me impakt të drejtpërdrejtë tek çdo grupmoshë e popullsisë që përfshihen në territorin e BT-së. Vëmendje edhe për këtë vit do të kenë rehabilitimet e blloqeve të banimit si dhe nxitja e bashkëpunimit efektiv mes BT-së dhe qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës së objekteve në bashkëpronësi.
- **Transporti për të gjithë:** Transporti për të gjithë përbëhet nga një grup politikash me fokus rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe rritjen e aksesueshmërisë së qytetit nga të gjithë. Ky objektiv është një ndër më sfiduesit dhe synon të nxisë mobilitetin alternativ nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të korsive të dedikuara për biçikleta dhe përmirësimin të shërbimit të operatorëve në këtë fushë, të përmirësojë situatën e parkimit nëpërmjet rritjes së kapacitetit dhe përdorimin eficient të hapësirave ekzistuese dhe përmirësimin të shërbimit të parkimit me pagesë.
- **Qeverisja e mirë:** Bashkia Tiranë ka përcaktuar si prioritet të saj forcimin e qeverisjes së mirë dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve i cili do të realizohet nëpërmjet 3 programeve: *Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit nëpërmjet: Rritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjes së qytetarëve dhe komuniteteve në vendimmarrje nëpërmjet: Administrimin më të mirë të të ardhurave të Bashkisë:*

- **Tirana si Kryeqyteti i Sportit për vitin 2023:** Zhvillimi i Tiranës vijon të jetë në vëmendjen ndërkombëtare, për politikën e ndjekura në zhvillimin e rinisë, sportit, kulturës. Tirana sapo është shpallur fituese e titullit “Kryeqyteti i Sportit për vitin 2023”, i cili sikurse titulli për Rininë, do të jetë një mundësi shumë e mirë për të theksuar, nëpërmjet projekteve të dedikuara, fokusin që Bashkia e Tiranës ka në zhvillimin dhe promovimin e Sportit si kulturë.

2. Kuadri Ligjor

Raporti i monitorimit është në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit nr. 22 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të NJQV”, udhëzimit plotësues nr.2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", VKB nr. 126, datë 23.12.2022 “Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023, (i ndryshuar),

3. Përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit

Procesi i monitorimit vlerëson performancën e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe njësisë të varësisë duke bërë një krahasim ndërmjet treguesve faktik të performancës me ato të planifikuara. Ky proces është realizuar në 10 funksione që përmban Bashkia Tiranë për vitin 2023, pjesë e zbatimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe Buxhetit 2023.

Bashkia Tiranë administron dhe menaxhon fondet sipas programeve të miratuara si më poshtë:

Funksioni 1 SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Programi - 01110: Planifikim menaxhim administrim

Programi - 01170: Gjendja civile

Programi - 01620: Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore

Funksioni 3 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Programi – 03140: Shërbimet policise vendore

Programi - 03280: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile

Funksioni 4 ÇESHTJE EKONOMIKE

Programi - 04130: Mbeshtetje për zhvillim ekonomik

Programi - 04220: Shërbimet bujqesore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit

Programi - 04240: Menaxhimi i infrastruktures së ujërës dhe kullimit

Programi - 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Programi - 04520: Rrjeti rrugor rural

Programi - 04570: Transporti publik

Funksioni 5 MBROJTJA E MJEDISIT

Programi - 05100: Menaxhimi i mbetjeve

Funksioni 6 STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi - 06140: Planifikim urban vendor

Programi - 06190: Strehimi
Programi - 06210: Programet e Zhvillimit
Programi - 06260: Sherbimet Publike vendore
Programi - 06220: Menaxhimi I Mbetjeve Urbane

Funksioni 8 ARGETIMI KULTURA DHE FEJA

Programi - 08130: Sport dhe argetim
Programi - 08220: Trashegimia kulturore, eventetartistike dhe kulturore
Programi - 08230: Arti dhe Kultura

Funksioni 9 ARSIMI

Programi - 09120: Arsimi baze perfshire arsimi parashkollor
Programi - 09230: Arsimi i mesem i pergjithshem
Programi - 09240: Arsimi profesional
Programi - 09450: Arsimi Universitar

Funksioni 10 MBROJTJA SOCIALE

Programi- 10910: Emergjenca Civile
Programi - 10430: Kujdesi social per familjet dhe femijet
Programi - 10661: Strehimi social

4. Tabelat e raportimit të monitorimit

Buxheti fillestar vjetor i vitit 2023 ka qenë **27,490,229,645** lekë. Buxheti i Bashkisë Tiranë, pas zbatimit të VKB Nr. 23, datë 17.03.2023 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.126, datë 23.12.2022, të këshillit bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së tiranës për vitin 2023”, VKB Nr. 47 datë 03.05.2023 për një ndryshim në vendimin nr.21 dt 17.03.2023 të KB për miratimin e nivelit te pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake, VKB Nr. 49 datë 03.05.2023 për miratimin e nivelit të pagave të njësive administrative dhe lagjeve të Bashkisë së Tiranës, VKB Nr. 50 datë 03.05.2023 për miratimin e nivelit të pagave për punonjesit e institucioneve në varesi të Bashkisë Tiranë , VKB Nr. 63 datë 31.05.2023 për dhënien e ndihmës financiare për rajonin e Emilia Romagna me qëllim lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmytjet ,VKB Nr. 82, datë 20.07.2023 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.126 dt 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të BT për vitin 2023 të ndryshuar, VKB Nr. 84, datë 20.07.2023 VKB për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të BT, si dhe referuar transfertave të kushtëzuara shkon në vlerën **41,760,997,686** mijë lekë.

Shtesat në buxhet jepen të detajuara në vazhdim:


- a.** Fondet e trashëguara nga të ardhurat e Bashkisë nga viti 2022 për vitin 2023, në shumën 5,581,298,094 lekë.
- b.** Fondet e trashëguara nga transferta e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme nga viti 2022 për vitin 2023, në shumën 1,130,438,851 lekë.
- c.** Fondet e trashëguara nga transferta e pakushtëzuar (fonde rindërtimi) nga viti 2022 për vitin 2023, në shumën 1,846,033,212 lekë.
- d.** Fondet e trashëguara nga fondet e donatorëve nga viti 2022 për vitin 2023, në shumën 45,783,475 lekë.

Për periudhën janar-gusht 2023, janë kryer edhe rishpërndarje fondesh midis zërave të shpenzimeve brenda të njëjtit program me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

4.1 Realizimi i të ardhurave për periudhën janar - gusht 2023

Realizimi I të ardhurave për 8 mujorin e parë të vitit 2023 paraqitet më poshtë në formë tabelare dhe grafike në dy ndarjet kryesore përkundrejt planit të vitit 2023.

| Lloji i të ardhurave | Plan 2023 | Fakt 8M-2023 |
|-----------------------------|-----------------------|-----------------------|
| Të ardhura tatimore | 10,879,500,000 | 7,452,160,837 |
| Të ardhura jo-tatimore | 5,554,000,000 | 4,131,622,851 |
| Total i të ardhurave | 16,433,500,000 | 11,583,783,688 |




Përqindja e realizimit për 8 mujor është në masën 70% kundrejt planit vjetor.

Një prej taksave dhe tarifave që kanë pasur një realizim të mirë kundrejt planit vjetor dhe atij 8 mujorë është taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me një realizim prej 76% kundrejt planit vjetor dhe 115% kundrejt atij 8 mujor. Parashikimi I kësaj takse në përgjithësi bëhet me rezerva duke pasur parasysh se kjo taksë varet nga numri I aplikimeve për leje ndërtimi nga subjektet. Kjo taksë mban peshën më të madhe të të ardhurave që Bashkia Tiranë grumbullon vitet e fundit, përkatesisht këtë 8 mujor në masën 36.7% përkundrejt realizimit total.

Të ardhurat e realizuara nga kjo taksë përkundrejt planit vjetor dhe 8 mujor paraqiten më poshtë:
në lekë

| Lloji I taksës | Plan 2023 | Plan 8M 2023 | Fakt 8M 2023 |
|---|---------------|---------------|---------------|
| Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 5,559,000,000 | 3,706,000,000 | 4,243,555,676 |

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja



Taksa dhe tarifa të cilat kanë realizim të mirë gjatë 8 mujorit të parë të vitit 2023 kundrejt planit 8 mujor janë:

- Taksa e reklamës në masën 102%
- Tarifa për zënien e hapësirave publike në masën 111%
- Taksa e fjetjes në hotel në masën 117%
- Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime në masën 211%
- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura më masën 113%

4.2 Tabela e raportit të shpenzimeve sipas programeve

Buxheti i planifikuar për vitin 2023 i Bashkisë Tiranë i ndarë sipas programeve paraqitet si vijon:
në lekë

| Emërtimi | Plan 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | % ndaj planit vjetor | struktura /plani vjetor |
|--|-----------------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|-------------------------|
| <i>Planifikim, Menaxhim & Administrim</i> | 4,284,755,397 | 2,970,753,851 | 1,922,979,607 | 45% | 10% |
| <i>Gjendja Civile</i> | 70,871,532 | 53,251,532 | 43,771,448 | 62% | 0% |
| <i>Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore</i> | 35,669,900 | 35,669,900 | 32,861,600 | 92% | 0% |
| <i>Shërbimet e Policise Vendore</i> | 716,600,000 | 479,820,000 | 396,988,023 | 55% | 2% |
| <i>Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile</i> | 863,330,140 | 821,144,140 | 246,032,219 | 28% | 2% |
| <i>Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik</i> | 987,582,341 | 831,856,267 | 106,222,659 | 11% | 2% |
| <i>Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve</i> | 421,039,714 | 314,959,530 | 177,132,990 | 42% | 1% |
| <i>Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit</i> | 58,669,015 | 18,274,481 | 4,370,520 | 7% | 0% |
| <i>Administrimi i Pyjeve & Kullotave</i> | 11,669,502 | 9,312,584 | 6,219,595 | 53% | 0% |
| <i>Rrjeti Rrugor Rural</i> | 5,154,303,219 | 3,528,790,542 | 1,489,433,201 | 29% | 12% |
| <i>Transporti Publik</i> | 803,913,028 | 671,859,800 | 310,038,107 | 39% | 2% |
| <i>Menaxhim i Mbetjeve</i> | 2,046,480,901 | 1,519,007,229 | 1,253,033,237 | 61% | 5% |
| <i>Planifikim Urban Vendor</i> | 3,309,615,825 | 2,708,803,872 | 338,905,423 | 10% | 8% |
| <i>Strehimi</i> | 212,078,856 | 212,078,856 | 129,855,425 | 61% | 1% |
| <i>Programet e Zhvillimit</i> | 975,173,866 | 963,019,607 | 330,230,429 | 34% | 2% |
| <i>Menaxhimi i mbetjeve urbane</i> | 200,000,000 | 200,000,000 | 198,742,004 | 99% | 0% |
| <i>Shërbimet Publike Vendore</i> | 6,084,912,326 | 4,250,222,370 | 1,697,533,958 | 28% | 15% |
| <i>Sport dhe Argëtim</i> | 864,135,775 | 685,611,575 | 483,728,882 | 56% | 2% |
| <i>Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore</i> | 1,141,004,192 | 879,139,729 | 514,309,043 | 45% | 3% |
| <i>Arti dhe Kultura</i> | 448,039,000 | 448,039,000 | 385,703,630 | 86% | 1% |
| <i>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</i> | 4,754,919,296 | 3,870,659,023 | 2,082,330,252 | 44% | 11% |
| <i>Arsimi i mesëm i përgjithshëm</i> | 2,416,136,335 | 1,887,014,927 | 1,204,229,651 | 50% | 6% |
| <i>Arsimi Profesional</i> | 32,083,560 | 32,083,560 | 20,410,320 | 64% | 0% |
| <i>Përkujdesje Sociale</i> | 2,636,432,941 | 2,545,435,941 | 1,911,728,839 | 73% | 6% |
| <i>Strehimi Social</i> | 2,310,894,326 | 1,228,667,834 | 278,096,868 | 12% | 6% |
| <i>Emergjencia Civile</i> | 355,965,523 | 355,965,523 | 89,920,400 | 25% | 1% |
| <i>Fondi Rezervë</i> | 524,721,176 | 329,977,076 | - | 0% | 1% |
| <i>Fondi i Kontigjencës</i> | 40,000,000 | 25,000,000 | - | 0% | 0% |
| TOTAL | 41,760,997,686 | 31,876,418,749 | 15,654,808,330 | 37% | 100% |

- **Programi Shërbimet Publike Vendore** i cili përbën 15% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 28% të 8-mujorit 2023.

- **Programi Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor** i cili përbën 11% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 44% të 8-mujorit 2023.


-**Programi Rrjeti Rrugor** i cili përbën 12% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 29% të 8-mujorit 2023.

-**Programi Planifikim, Menaxhim, Administrim** i cili përbën 10% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 45% të 8-mujorit 2023.

-**Programi Planifikimi Urban Vendor** i cili përbën 8% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 10% të 8-mujorit 2023.

-**Programi Përkujdesje Sociale** i cili përbën 6% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 73% të 8-mujorit 2023.

-**Programi Shërbimet e Policise Vendore** i cili përbën 2% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 55% të 8-mujorit 2023



4.3 Tabela e raportit të shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik


Në total, Bashkia Tiranë ka një realizim prej 45% të planit 8-mujor 2023. Kjo vlerë përfshin të gjitha burimet e financimit.

Referuar klasifikimit ekonomik, realizimi nga të ardhurat paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit janë realizuar me 85%,
- Shpenzimet operative me 55% dhe
- Shpenzimet kapitale me 23%.

Më poshtë paraqitet në mënyrë tabelare informacioni i mësipërm:

| Shpenzimet klasifikimit sipas | Faktik 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | në lekë | |
|-------------------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|----------------|
| | | | | Fakti 8M 2023 | Realizimi në % |
| Shpenzime personeli | 3,964,414,249 | 8,384,801,399 | 5,662,021,055 | 4,800,213,829 | 85% |
| Shpenzime të tjera operative | 6,909,167,178 | 14,400,814,596 | 11,683,800,241 | 6,988,293,522 | 60% |
| Shpenzime kapitale | 4,532,178,648 | 18,975,381,691 | 14,530,597,453 | 3,866,300,979 | 27% |
| Totali | 15,405,760,075 | 41,760,997,686 | 31,876,418,749 | 15,654,808,330 | 49% |




4.4 Tabela e raportit sipas burimeve të financimit

Shpenzimet sipas burimeve të financimit për 8-mujor 2023, paraqiten si më poshtë:

në lekë

| Shpenzimet sipas klasifikimit | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | Realizimi 8M në % | Struktura vjetore |
|--|-----------------------|-----------------------|-----------------------|-------------------|-------------------|
| <i>Të ardhura BT</i> | 29,763,963,024 | 21,278,056,824 | 9,726,324,271 | 46% | 71% |
| <i>Transferta e Pakushtëzuar +Sektoriale</i> | 5,526,306,775 | 4,264,216,360 | 2,366,498,868 | 55% | 13% |
| <i>Transferta e Pakushtëzuar Rindërtimi</i> | 1,846,033,212 | 1,846,033,212 | 509,573,711 | 28% | 4% |
| <i>Transferta e Kushtëzuar</i> | 4,019,027,174 | 4,001,407,174 | 3,046,506,745 | 76% | 10% |
| <i>Donacione</i> | 57,482,497 | 38,117,685 | 3,065,787 | 8% | 0% |
| <i>Financime të huaja</i> | 297,349,934 | 297,349,934 | 0 | 0% | 1% |
| <i>TVSH Detyrimi</i> | 250,835,070 | 151,237,560 | 2,838,948 | 2% | 1% |
| Totali | 41,760,997,686 | 31,876,418,749 | 15,654,808,330 | 49% | 100% |

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme, burimi kryesor i financimit për buxhetin 8-mujor 2023 vijon të jetë nga të ardhurat e Bashkisë, në vlerën faktike 9,726,324,271 lekë e cila përbën 71% të të ardhurave totale faktike. Fondet e Pakushtëzuara dhe Sektoriale zënë 13% të burimeve të financimit të planifikuara, Fondet e Pakushtëzuara Rindërtimi zënë 4% të burimeve të financimit të planifikuara. Fondet e Kushtëzuara zënë 10% të strukturës së burimeve të financimit, sipas grafikut më poshtë:




.5 Tabela e raportit të donacioneve

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e burimit Donator në bazë programesh: në Lekë

| | Emërtimi | Plan 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | % ndaj planit vjetor | struktura/plani vjetor |
|-------|--|------------|---------------|---------------|----------------------|------------------------|
| 01110 | Planifikim, Menaxhim & Administrim | 20,050,898 | 686,086 | - | 0% | 35% |
| 03280 | Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile | 555,000 | 555,000 | - | 0% | 1% |
| 04130 | Mbështetja për zhvillim ekonomik | 28,639,350 | 28,639,350 | - | 0% | 50% |
| 08220 | Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore | 90,183 | 90,183 | - | 0% | 0% |
| 09120 | Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor | 7,376,151 | 7,376,151 | 3,065,787 | 42% | 13% |
| 09230 | Arsimi I mesëm I përgjithshëm | 500,344 | 500,344 | - | 0% | 1% |
| 10430 | Përkujdesja Sociale | 270,571 | 270,571 | - | 0% | 0% |

Donacionet sipas programeve



4.6 Tabela e raportit të fondeve të kushtëzuara

Në tabelën më poshtë paraqiten fonde të transferuara gjatë kësaj periudhe për Bashkinë Tiranë si rezultat i funksioneve të deleguara për këtë periudhë 8-mujorit 2023. Këtu përfshihen fonde që janë deleguar nga qeverisja qendrore nëpërmjet ministrive të linjës për funksionet e deleguara për:

- Gjendjen Civile
- Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore
- Ndihmën Ekonomike
- Ndihmë për Personat me Aftësi të Kufizuar
- Kuota për shërbime të ndryshme sociale, Bursa
- Transferime
- Projekte të reja arsimore e kulturore

në lekë

| | Emertimi | Plan 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | % |
|-------|---|----------------------|----------------------|----------------------|------------|
| 01170 | Gjendja Civile | 70,871,532 | 53,251,532 | 43,771,448 | 62% |
| 01620 | Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore | 35,669,900 | 35,669,900 | 32,861,600 | 92% |
| 06190 | Strehimi | 212,078,856 | 212,078,856 | 129,855,425 | 61% |
| 06220 | Menaxhimi I mbetjeve urbane | 200,000,000 | 200,000,000 | 198,742,004 | 99% |
| 08230 | Arti dhe Kultura | 448,039,000 | 448,039,000 | 385,703,630 | 86% |
| 09120 | Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor | 398,507,053 | 398,507,053 | 378,399,017 | 95% |
| 09230 | Arsimi i mesëm i përgjithshëm | 13,237,750 | 13,237,750 | 9,222,750 | 70% |
| 09240 | Arsimi Profesional | 32,083,560 | 32,083,560 | 20,410,320 | 64% |
| 10430 | Përkujdesja Sociale | 2,252,574,000 | 2,252,574,000 | 1,757,620,151 | 78% |
| 10910 | Emergenca Civile | 355,965,523 | 355,965,523 | 89,920,400 | 25% |
| | TOTAL | 4,019,027,174 | 4,001,407,174 | 3,046,506,745 | 76% |

Sipas produkteve dhe llogarive ekonomike fondet e deleguara paraqiten si më poshtë:

| Min | Pershkrimi | Llogaria ekonomike | Plani 2023 | Faktik 8 Mujorin | Realizimi ne % |
|-----|---|--------------------|----------------------|----------------------|----------------|
| 06 | Impianti për prodhimin e energjisë nga mbetjet në Tiranë Inceneratori (90610AA) | 602 | 200,000,000 | 198,742,004 | 99% |
| 10 | Subvencionim I qerasw pwr familjet e prekura nga termeti | 606 | 125,385,600 | 124,486,600 | 99% |
| 10 | Subvencionim I qerasw pwr familjet e prekura nga shpronësimi Unaza e Madhe e Tiranws | 606 | 86,693,256 | 5,368,825 | 6% |
| 10 | Bursa të përfutuar nga nxënësit AP | 606 | 32,083,560 | 20,410,320 | 64% |
| 11 | Per permiresimin e Infrastruktures Arsimore ne Bashkine e Tiranes "Per projektimin,financimin,ndertimin,mobilimin,mirembajtjen,mbikq | 231 | 219,871,223 | 219,871,223 | 100% |
| 11 | Per permiresimin e Infrastruktures Arsimore ne Bashkine e Tiranes "Per projektimin,financimin,ndertimin,mobilimin,mirembajtjen,mbikq yrjen dhe kolaudimin e pese objekteve arsimore ne Zonen Tirana 1"dhe Zona Tirana 4 | 231 | 112,817,580 | 112,817,580 | 100% |
| 11 | Fëmijë në nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilësor (91103AC) | 602 | 65,818,250 | 45,710,214 | 69% |
| 11 | Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm te lartë në institucione publike (91104AA) | 602 | 13,237,750 | 9,222,750 | 70% |
| 12 | Rijetësimi i Piramidës Tiranë | 231 | 448,039,000 | 385,703,630 | 86% |
| 13 | Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE (91307AA) | 606 | 230,108,000 | 144,630,875 | 63% |
| 13 | PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa (91307AB) | 606 | 2,022,466,000 | 1,612,989,276 | 80% |
| 16 | Paga (91603AA) | 600 | 58,276,000 | 35,365,493 | 61% |
| 16 | Sigurime Shoqërore (91603AA) | 601 | 9,732,000 | 5,542,595 | 57% |
| 16 | Fond për zgjedhjet vendore | 602 | 2,803,532 | 2,803,360 | 100% |
| 16 | Transferim | 606 | 60,000 | 60,000 | 100% |
| 17 | Rehabilitim emergjent I perroit te Gjerozes tek Fresku L-260m | 231 | 71,713,033 | - | 0% |
| 17 | Shtetas te demtuar , banesat e te cileve jane demtuar nga fatkeqesi te ndryshme /91707AB | 604 | 146,000,000 | 89,920,400 | 62% |
| 17 | Shtetas te demtuar , banesat e te cileve jane demtuar nga fatkeqesi te ndryshme /91707AG | 604 | 138,252,490 | - | 0% |
| 73 | Fond per pagesen e komisionereve zgjedhjet vendore | 600 | 33,395,500 | 30,981,000 | 93% |
| 73 | Transport i bazës materiale për zgjedhjet 14 maj 2023 | 602 | 2,274,400 | 1,880,600 | 83% |
| | TOTALI | | 4,019,027,174 | 3,046,506,745 | 76% |

4.7 Tabela e raportit të investimeve .

| | Emërtimi | Plani 2023 | Plan 8M 2023 | Fakt 8M 2023 | % | struktura vjetore |
|------|---|---------------|---------------|--------------|-----|-------------------|
| 1110 | Planifikim, Menaxhim & Administrim | 407,852,961 | 354,206,441 | 60,683,508 | 17% | 15% |
| 3140 | Shërbimet e Policise Vendore | 52,500,000 | 45,000,000 | | 0% | 0% |
| 3280 | Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile | 196,453,420 | 194,453,420 | 81,450,351 | 42% | 41% |
| 4130 | Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik | 792,687,230 | 669,975,156 | 35,306,628 | 5% | 4% |
| 4220 | Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve | 139,841,984 | 119,017,800 | 53,882,608 | 45% | 39% |
| 4240 | Menaxhim I Infrastrukturës se Ujitjes & Kullimit | 35,329,293 | - | | | 0% |
| 4520 | Rrjeti Rrugor Rural | 3,823,217,095 | 2,567,392,669 | 800,221,020 | 31% | 21% |

| | | | | | | |
|-------|--|-----------------------|-----------------------|----------------------|------------|------------|
| 4570 | Transporti Publik | 156,038,496 | 127,165,268 | 41,828,968 | 33% | 27% |
| 6140 | Planifikim Urban Vendor | 2,437,069,210 | 1,984,562,757 | 150,226,630 | 8% | 6% |
| 6210 | Programet e Zhvillimit | 12,154,259 | - | | | 0% |
| 6260 | Sherbimet Publike Vendore | 4,184,668,976 | 2,906,297,417 | 648,984,953 | 22% | 16% |
| 8130 | Sport dhe Argëtim | 20,139,905 | 20,139,905 | 4,651,180 | 23% | 23% |
| 8220 | Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore | 169,384,151 | 158,302,248 | 80,233,993 | 51% | 47% |
| 9120 | Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor | 1,221,895,099 | 1,110,192,903 | 284,862,763 | 26% | 23% |
| 9230 | Arsimi I mesëm I përgjithshëm | 948,797,732 | 783,386,773 | 417,618,381 | 53% | 44% |
| 10430 | Përkujdesje Sociale | 15,093,820 | 15,093,820 | 6,933,332 | 46% | 46% |
| 10661 | Strehimi Social | 1,686,847,184 | 800,000,000 | | 0% | 0% |
| | Total | 16,299,970,815 | 11,855,186,577 | 2,666,884,315 | 22% | 16% |

Raportimi i detajuar i investimeve paraqitet nw aneksin nr 5 bashkwlidhur raportit.

4.8 Përdorimi i fondit rezervë dhe fondit të kontigjencës

Fondi Rezervë për periudhën Janar –Gusht 2023, është përdorur si mëposhtë:

-VKB nr.23, datë 17.03.2023 “Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.126, datë 23.12.2022, të këshillit bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së tiranës për vitin 2023”, në shumën 1,069,744,100 lekë.

-VKB nr.47, datë 03.05.2023 “Ndryshim në vendimin nr.21, datë 17.3.2023 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë”, pakësuar në shumën 24,000,000 lekë.

-VKB nr.49 dt 03.05.2023 “Miratimi i nivelit të pagave të Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë Tiranë”, pakësuar në shumën 28,000,000 lekë.

-VKB nr.50 dt 03.05.2023 “Miratimi i nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Tiranë, pakësuar në shumën 149,330,000 lekë.

-VKB nr.63 dt 31.05.2023 “Dhënia e ndihmës financiare nga Bashkia e Tiranës për rajonin e Emilia-Romagna me qellim lehtësimin e pasojave të demeve të shkaktuara nga permbytjet masive”, pakësuar në shumën 11,062,000 lekë.

-VKB nr.84 dt 20.07.2023 “Miratimi i nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Tiranës”, pakësuar në shumën 140,000,000 lekë.

VKB nr.82 dt 20.07.2023 “Shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.26, date 23.12.2022 te Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023 të ndryshuar”, pakësuar në shumën 492,630,924 lekë.

Nga Fondi i Kontigjencës përgjatë periudhës Janar-Gusht 2023 nuk ka pasur përdorim fondi.

5. Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Programi 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim

Ky program përfshin:

1. Aparatin e Bashkisë
3. Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore

Qëllimi I programit - të zhvillojë dhe zbatojë politikat e përgjithshme për personelin; Shërbime të përgjithshme publike. Të merret me administrim, funksionim dhe ofrimin e shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë; Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit; Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj; Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale;

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 65%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 91%
- Shpenzime të tjera operative 47%
- Shpenzime kapitale 17%

në lekë

| Shpenzimet klasifikimit sipas | Fakti 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | Realizimi në % |
|-------------------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------|
| <i>Shpenzime personeli</i> | 957,119,005 | 2,209,990,125 | 1,430,964,125 | 1,308,840,267 | 91% |
| <i>Shpenzime të tjera operative</i> | 533,808,648 | 1,644,488,275 | 1,163,159,249 | 550,642,187 | 47% |
| <i>Shpenzime kapitale</i> | 83,558,600 | 430,276,997 | 376,630,477 | 63,497,153 | 17% |
| Totali | 1,574,486,253 | 4,284,755,397 | 2,970,753,851 | 1,922,979,607 | 65% |

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:

Realizimi i shpenzimeve në programin Planifikim, Menaxhim & Administrim



O motivimi dhe angazhimi i punonjësve të administratës. Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Bashkisë së Tiranës dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj. Për arritjen e këtij objektiv, për 8-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:
 Produkti 1: "Trajnim dhe Zhvillim i Stafit të Bashkisë Tiranë" për 8-mujorin 2023 është planifikuar 8,000,000 lekë dhe është realizuar 0% e planit 8-mujor. Për vitin 2023 janë planifikuar të trajnohen 680 punonjë në Bashkinë e Tiranës.

Produkti 2: "Ri-optimizimi dhe Standartizimi i proceseve të punës së strukturës së institucionit të Bashkisë Tiranë" për 8-mujorin 2023 është planifikuar 33,800,000 lekë, dhe është realizuar në vlerën 33,000,000 lekë. Nëpërmjet këtij produkti kërkohet të maksimizohet struktura me të cilën funksionon institucioni i Bashkisë Tiranë dhe në të njëjtën kohë të trajnohen stafet që i përdorin këto procese, të rritet eficienta organizative duke i përmirësuar këto procese nëpërmjet eliminimit të proceseve që zgjasin shërbimet në kohë, mirëpërcaktimin e mbarëvajtjes së punës, përmirësimin e komunikimit ndërmjet drejtorive dhe parashikimin e ndryshimeve. Në të njëjtën kohë synohet të arrihet përafrimi me Standartet e Bashkimit Europian dhe përcaktimin e të gjitha elementeve ligjore që mund të kenë nevojë për përmirësim.

Objektivi II i këtij programi është: Rritja e transparencës dhe imazhit të Bashkisë Tiranë kundrejt përthithjes së kandidatëve për t'u rekrutuar si nëpunës civilë dhe praktikantëve për të siguruar një edukim sa më të mirë të qytetarëve me tregun e punës dhe përfitimin e kraheve shtesë të forcës punëtore në Bashki në mënyrë eficiente. Për arritjen e këtij objektiv, për 8-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti "Fillo me një ide, fito një praktikë pune në Bashkinë Tiranë" për 8-mujorin 2023 është planifikuar 3,563,000 lekë dhe nuk ka patur realizim për 8 mujorin.

Produkti 2: Panairi i Punës për 8-mujorin 2023 është planifikuar 1,000,000 lekë dhe është realizuar 100% e planit.

Produkti 3: Projekti "Ëeb-Challenge Tirana" për 8-mujorin 2023 është planifikuar 2,800,000 lekë dhe nuk ka patur realizim për planin 8 mujor. Ky projekt lindi si nevojë e kërkesave të të rinjve për të marrë pjesë në ndërtimin e ëbsiteve dhe fushës së dizajnit gjatë panairit të punës. Nën mbikqyrjen e Drejtorisë së Trajnimit dhe Zhvillimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe të Dhënave, të rinjtë do të konkurojnë me idetë e tyre ku do të trajnohen dhe do të vlerësohen me një internship 3 mujor dhe vlerë monetare përgjatë projektit.

Objektivi III i këtij programi është: "Shërbime të përgjithshme publike, administrim, funksionim dhe ofrim i shërbimeve të mbështetjes për aparatin e Bashkisë Tiranë". Për arritjen e këtij objektiv, për 8-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: "Shërbime të integruara sigurie për godinat, në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe institucionet e tjera të Bashkisë Tiranë", është planifikuar 337,398,392 lekë dhe është realizuar 18% e planit 8 mujor.

Objektivi IV i këtij programi është: “Të asistohen dhe nxiten tatimpaguesit në mënyrë që të likujdojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor. Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit.” Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2023 është realizuar produkti me të dhëna si më poshtë:
Produkti 1: Nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor nëpërmjet informimit, për 64,735 tatim pagues aktivë, janë shpenzuar 20,480,449 lekë nga 36,548,000 lekë të planifikuar për vitin 2023.

Programi - 01170: Gjendja civile


Përshkrimi i programit:

Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Zbatimi i buxhetit për shërbimet e deleguara (Gjendjes civile) bazohet tek ligji nr. 10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar; dhe VKM nr. 1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjendjes civile në Bashki/ njësi Bashkiake/ komuna dhe në degët e qarqeve" i ndryshuar . Pagat i referohen VKM nr. 187, datë 8.3.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/ nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, Gjykatën e lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit" i ndryshuar.

Realizimi i buxhetit për 8 mujorin 2023 për këtë program paraqitet si më poshtë:

| Shpenzimet sipas klasifikimit | në lekë | | në lekë | | Realizimi në % |
|-------------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|----------------|
| | Fakti 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | |
| <i>Shpenzime personeli</i> | 51,984,873 | 68,008,000 | 50,883,000 | 40,908,088 | 80% |
| <i>Shpenzime të tjera operative</i> | 1,214,038 | 2,863,532 | 2,863,532 | 2,863,360 | 100% |
| <i>Shpenzime kapitale</i> | | | | | |
| Totali | 53,198,911 | 70,871,532 | 53,746,532 | 43,771,448 | 81% |

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Programi - 01620: Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore


Përshkrimi i programit:

Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit të zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Realizimi i buxhetit për 8 mujorin 2023 për këtë program paraqitet si më poshtë:

| | | | | | | | në lekë | |
|-------------------------------|---------------|-------------------|-------------------|-------------------|----------------|--|---------|--|
| Shpenzimet sipas klasifikimit | Fakti 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | Realizimi në % | | | |
| Shpenzime personeli | | 33,395,500 | 33,395,500 | 30,981,000 | 93% | | | |
| Shpenzime të tjera operative | | 2,274,400 | 2,274,400 | 1,880,600 | 83% | | | |
| Shpenzime kapitale | | | | | | | | |
| Totali | - | 35,669,900 | 35,669,900 | 32,861,600 | 92% | | | |

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Funksioni 3 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Programi – 03140: Shërbimet policise vendore

Në këtë program bën pjesë Aparati i Bashkisë

Qëllimi i programit të Policisë Bashkiake është: Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të Bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të Bashkisë dhe këshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 83%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 97%
- Shpenzime të tjera operative 13%
- Shpenzime kapitale 0%

në lekë

| Shpenzimet sipas klasifikimit | Fakti 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | Realizimi në % |
|-------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|----------------|
| Shpenzime personeli | 301,955,173 | 633,410,000 | 406,630,000 | 393,397,423 | 97% |
| Shpenzime të tjera operative | 27,527,820 | 30,690,000 | 28,190,000 | 3,590,600 | 13% |
| Shpenzime kapitale | 2,577,939 | 52,500,000 | 45,000,000 | - | 0% |
| Totali | 332,060,932 | 716,600,000 | 479,820,000 | 396,988,023 | 83% |

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 8-mujorin 2023 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Investimet për programin Shërbimet e Policisë Vendore për vitin 2023 janë 10 projekte / investime që menaxhohen nga Institucioni që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 52,500,000 lekë për 8-mujorin 2023 dhe nuk ka patur realizim për 8-mujorin.

Programi - 03280: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. MZSH

Qëllimi i programit të Emergjencave Civile është: Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 30%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 61%
- Shpenzime të tjera operative 14%


- Shpenzime kapitale

42%

në lekë

| Shpenzimet sipas klasifikimit | Faktik 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | Realizimi në % |
|-------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|----------------|
| Shpenzime personeli | 90,218,368 | 203,762,501 | 168,276,501 | 102,433,747 | 61% |
| Shpenzime të tjera operative | 188,027,139 | 462,559,219 | 457,859,219 | 62,148,121 | 14% |
| Shpenzime kapitale | 3,576,196 | 197,008,420 | 195,008,420 | 81,450,351 | 42% |
| Totali | 281,821,703 | 863,330,140 | 821,144,140 | 246,032,219 | 30% |

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 8-mujorin 2023 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Demolim dhe evadim i mbetjeve ndërtimore në Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 2,919,000 lekë për 8-mujorin 2023, dhe nuk ka patur realizim për 8-mujorin.
- Investimet për programin e Mbrojtjes Nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile për vitin 2023 përbëhet nga 38 projekte/investime të Emergjencës Civile me një realizim 81,450,351 lekë dhe 2 projekte/investime të Mbrojtjes nga Zjarri që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion.

FUNKSIONI 4 ÇESHTJE EKONOMIKE

Programi - 04130: Mbeshtetje për zhvillim ekonomik

Në këtë program bën pjesë:

1. Aparati i Bashkisë
2. Agjencia e Administrimit të Tregjeve

Qëllim i programit te programit :

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
- Mbeshtetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike

- Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 13%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

| | |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit | 94% |
| - Shpenzime të tjera operative | 44% |
| - Shpenzime kapitale | 0% |

në lekë

| Shpenzimet sipas klasifikimit | Faktik 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | Realizimi në % |
|-------------------------------------|------------------|--------------------|--------------------|--------------------|----------------|
| <i>Shpenzime personeli</i> | | 44,270,000 | 28,756,000 | 27,138,975 | 94% |
| <i>Shpenzime të tjera operative</i> | 9,852,337 | 117,668,177 | 100,168,177 | 43,777,056 | 44% |
| <i>Shpenzime kapitale</i> | | 825,644,164 | 702,932,090 | 35,306,628 | 0% |
| Totali | 9,852,337 | 987,582,341 | 831,856,267 | 106,222,659 | 13% |

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2023 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 987,582,341 lekë për 8-mujorin 2023.

Objektivi I i këtij programi është: Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik Brenda territorit të njësisë vendore. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja të gjelbërta të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjelbërta” duke futur element go-green në to” për 8-mujorin 2023 është planifikuar 12,500,000 lekë dhe është realizuar 48% e planit.

Objektivi II i këtij programi është: Projekte që kanë për qëllim promovimin e turizmit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekte Turizmi për 8-mujorin 2023 është planifikuar 22,155,000 lekë dhe është realizuar 27% e planit 8 mujor.

Objektivi III i këtij programi është: Të hartojë, zbatojë dhe monitorojë politika të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Programi - 04220:Shërbimet bujqësore,inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit

Në këtë program bëjnë pjesë:

1. Aparati i Bashkisë
2. Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit është:


Të hartojë, zbatojë dhe monitorojë politika të përgjithshme ekonomike në lidhje me zhvillimin rural. Funkcionimin ose mbështetjen e politikave vendore të zhvillimit ekonomik, krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural dhe tregtar brenda njësisë si edhe të hartojë projekte të ndryshme në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit. Kontrolli ushqimor dhe mbrojtje te konsumatorit

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 56%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 88%
- Shpenzime të tjera operative 20%
- Shpenzime kapitale 45% në lekë

| Shpenzimet sipas klasifikimit | Faktik 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | Realizimi në % |
|-------------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|----------------|
| <i>Shpenzime personeli</i> | 102,573,347 | 192,200,000 | 123,344,000 | 108,917,122 | 88% |
| <i>Shpenzime të tjera operative</i> | 26,931,672 | 88,997,730 | 72,597,730 | 14,333,260 | 20% |
| <i>Shpenzime kapitale</i> | | 139,841,984 | 119,017,800 | 53,882,608 | 45% |
| Totali | 129,505,019 | 421,039,714 | 314,959,530 | 177,132,990 | 56% |

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2023 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Objektivi I i këtij programi është: Iniciativë për të nxitur prezantimin dhe promovimin e produkteve lokale dhe rurale. Për arritjen e këtij objektivi për 8-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: TiranAgro është projekti i cili do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të panairit vjetor, ku do të promovohen produktet bujqësore dhe blegtorale si: vreshtaria, bulmeti, mjalti, frutat e egra, bimët medicinale, etj., si dhe artizanët dhe prodhimet e tyre. Ky projekt do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë Administrative Rurale, Drejtori të ndryshme të Bashkisë Tiranë, si dhe shoqatat të cilat operojnë në fushën e artizanatit.

Objektivi II i këtij programi është: Hartimi i planeve të reja të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkisë Tiranë për të evidentuar gjendjen aktuale të fondit pyjor e kullësor, plane të cilat parashikojnë masat që duhen të ndërmerren në 10-vjeçarin e ardhshëm. Për arritjen e këtij objektivi për 8-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon

Produkti 1: Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Vërrit dhe Vorë. Ky projekt synon të përmirësojë menaxhimin e fondit pyjor dhe kullësor nëpërmjet vendosjes së rregullave të qarta për shfrytëzimin dhe përdorimin racional të pyjeve dhe kullotave.

Objektivi III i këtij programi është: Inspektimi dhe shërbimet për qytetarët, administrimi i thertores publike, si dhe mbrojtja e trajtimi i kafshëve endacake. Për arritjen e këtij objektivi për 8-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të tjera janë realizuar 7,857 kontrolle për 8 mujorin 2023. Shpenzimet faktike për këtë produkt janë 11,323,275 lekë.

Produkti 2: Trajtimi i ankesave të qytetarëve. Gjatë katër mujorit të dytë numri i ankesave të trajtuara është 1,430.

Programi -04240: Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Ky program përfshin institucionet:

1. Aparatin e Bashkisë Tiranë
2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Qëllimi I programit është:

Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 24%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 24%
- në lekë

| Shpenzimet sipas klasifikimit | Faktik 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 2023 | 8M | Realizimi në % |
|-------------------------------------|--------------------|-------------------|-------------------|------------------|----|----------------|
| <i>Shpenzime personeli</i> | - | 240,000 | 240,000 | - | | 0% |
| <i>Shpenzime të tjera operative</i> | 24,181,178 | 23,099,722 | 18,034,481 | 4,370,520 | | 24% |
| <i>Shpenzime kapitale</i> | 95,279,293 | 35,329,293 | - | - | | - |
| Totali | 119,460,471 | 58,669,015 | 18,274,481 | 4,370,520 | | 24% |

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve në programin Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit



Programi - 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Ky program përfshin institucionet:

1. Agjensia e Parqeve & Rekreacionit (pyjet)

Qëllimi I programit është:

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore si dhe administrim i fondit pyjor dhe kulloror public


Ky program menaxhohet nga Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit me fonde nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 34%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 71%
- në lekë

| Shpenzimet sipas klasifikimit | Faktik 8M 2022 | Plani 2023 | Plani 8M 2023 | Fakti 8M 2023 | Realizimi në % |
|-------------------------------------|------------------|-------------------|------------------|------------------|----------------|
| <i>Shpenzime personeli</i> | | 576,000 | 576,000 | - | 0% |
| <i>Shpenzime të tjera operative</i> | 6,464,500 | 11,093,502 | 8,736,584 | 6,219,595 | 71% |
| Totali | 6,464,500 | 11,669,502 | 9,312,584 | 6,219,595 | 67% |

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Programi - 04520: Rrjeti rrugor rural

Ky program përfshin institucionet:

1. Aparati i Bashkise
2. Drejtoria e Përgj. e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Qëllimi I programit është:

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore; Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2023, për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 42%.


